

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.05.2023*

**05.05.2023
Ora 14:30**

RENDI I DITËS

Shortit “Për caktimin e relatorit të kërkesës nr.18 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, E. Mema.**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 05.05.2023 në orën 14:30 zhvillohet seanca për caktimin e relatorit, për kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ. Kërkesa mban numrin 18, me denoncues zonjën Albana Vokshi, deputete e Kuvendit të Shqipërisë. Ajo pretendon se ka patur shpërdorime të burimeve publike për qëllime zgjedhore. Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në njërin është shënuar kërkesa për vendosje sanksioni administrativ me numër 18, shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Të gjithë shiritat palosen dhe vendosen në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së për të tërhequr goglat në emër dhe për llogari të tyre duke filluar nga rendi alfabetik rritës.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako – Kërkesa e Komisionerit me numër 18.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.05.2023*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, relator i kërkesës për vendosje sanksioni administrativ me numër 18 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është zoti Elvin Lako. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

